VENDIM
Nr. 400, datë 19.6.2024

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PËRGJITHSHME TË KREDIVE TË REJA PËR KATEGORITË PRIORITARE TË TË PUNËSUARVE PËRFITUES NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 64/3 e 64/5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të lehtësuara për administratën publike për vitin 2024 janë, gjithsej, 300 (treqind) dhe ndahen, si më poshtë vijon:
a) 90 (nëntëdhjetë) për Ministrinë e Brendshme;
b) 90 (nëntëdhjetë) për Ministrinë e Mbrojtjes;
c) 30 (tridhjetë) për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
ç) 30 (tridhjetë) për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
d) 45 (dyzet e pesë) për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
dh) 15 (pesëmbëdhjetë) për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Përfituesit sipas shkronjave "b", "c", "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë të kritereve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përfituesit sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë të kritereve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Përfituesit sipas shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij vendimi, janë punonjësit arsimorë në institucionet publike të arsimit parauniversitar, si pjesë e administratës publike, dhe përzgjidhen në bazë të kritereve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe tabelat bashkëlidhur, përzgjedhja e tyre realizohet sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar nga institucioni përfitues, për të realizuar numrin e kuotave të përcaktuara.

6. Punonjësit e administratës publike të përzgjedhur përfitojnë kredi të lehtësuar me interes 0 (zero) %.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA NR. 1: PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T'U TRAJTUAR ME KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	**50**
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës, që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
D.	Punonjës, që banon në banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	**25**
A.	Punonjës, që ka jo më pak se dy vjet i punësuar në administratën publike në momentin e	

	aplikimit	
B.	Punonjës, që ka jo më pak se shtatë vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C.	Punonjës, që i përket kategorisë "familje e re", në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
Ç.	Punonjës, që i përket kategorisë "të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjeç"	
D.	Familje njëprindërore, që ka në ngarkim fëmijë	
1.3	KUSHTET EKONOMIKE	**25**
A.	I përket kategorisë së pagës, sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave	
B.	I përket kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1	
C.	I përket kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2	

TABELA NR. 2: PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T'U TRAJTUAR ME KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	**50**
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës, që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
Ç.	Punonjës, që banon në banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	**25**
A.	Punonjës, që ka jo më pak se një vit i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit e që bën pjesë në përkufizimin e pikës 54, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social"	
B.	Punonjës, që ka jo më pak se pesë vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C.	Punonjës, që i përket kategorisë "familje e re", në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
Ç.	Punonjës, që i përket kategorisë "të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjeç"	
D.	Familje njëprindërore, që ka në ngarkim fëmijë	
1.3	KUSHTET EKONOMIKE	**25**
A.	I përket kategorisë së pagës sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023; nr. 325, datë 31.5.2023; nr. 200, datë 15.3.2017; nr. 688, datë 18.11.2021; nr. 350, datë 19.4.2017; nr. 321, datë 31.5.2023	
B.	I përket kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1 ose ekuivalente me to	
C.	I përket kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2 ose ekuivalente me to	

TABELA NR. 3: PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T'U TRAJTUAR ME KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	**50**
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës, që ka humbur banesën si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
Ç.	Punonjës, që banon në banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
D.	Punonjës, që banon në banesa në rrezik shembjeje, që ka mbetur ose rrezikon të mbetet i pastrehë, si rezultat i fatkeqësisë natyrore	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	**50**
A.	Punonjës arsimor, i cili, në momentin e aplikimit, është i punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar	
B.	Punonjës, i cili i përket kategorisë "familje e re", në kuptim të ligjit nr. 22/2018, për strehimin social, të ndryshuar, ku të dy bashkëshortët/bashkëjetuesit janë punonjës arsimorë	
C.	Punonjës, i cili punon jashtë vendbanimit mbi 100 kilometra larg e që qëndron në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet institucioni publik i arsimit parauniversitar, ku punon	